

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Përparim Zeka, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve **S.M.** nga Prishtina për shkak të veprës penale, Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 dhe 2, pika 2.1 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, **D.K.1.** nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe **D.K.2.** nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.246/17 datë 23.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 12.01.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.246/17 datë 23.10.2017, vetëm sa i përket vendimit mbi dënim për të akuzuarin S.M., ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës, të akuzuarit S.M., për veprën penale, Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 dhe 2, pika 2.1 të KPRK-së e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, ashtu që konform nenit 80 par.1 të KPRK-së të njejtit i shqipton dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 17.03.2017 e deri me dt. 28.07.2017 dhe nën masën e arrestit shtëpiak nga dt. 28.07.2017 deri me dt. 27.09.2017.

Aktgjykimi përkitazi me të akuzuarit D.K.1. dhe D.K.2. ngel i pa prekur.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin, PKR.246/17 datë 23.10.2017, të akuzuarin **S.M.** e ka shpallur fajtor dhe atë për veprën penale, Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 dhe 2, pika 2.1 të KPRK-së e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 2 (dy) muaj, dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj. Konform nenit 80 par.1 të KPRK-së të akuzuarit S.M. i shqipton dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj të cilin dënim nuk do ta vuaj në qoftë se në afatin prej 2 (dy) viteve, nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale. Në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 17.03.2017 e deri me dt. 28.07.2017 dhe nën masën e arrestit shtëpiak nga dt. 28.07.2017 deri me dt. 17.09.2017 në rast revokohet dënimi me kusht. Të akuzuarin **D.K.1.** e ka shpallur fajtorë për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, për çka e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj burgimi, të cilin dënim nuk do ta vuaj në qoftë se në afatin prej 1 (një) viti nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale. Të akuzuarin **D.K.2.** e shpallë fajtorë për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-së, për çka e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj burgim të cilin dënim nuk do ta vuaj në qoftë se në afatin prej 1 (një) viti nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale. Obligohen të akuzuarit që secili veç e veç në emër të shpenzimeve të procedurës penale ti paguajnë shumën aq sa do të bëhet sipas flete shpenzim orës së kësaj gjykate. Obligohen i akuzuari S.M. që në emër të paushallit gjyqësore ta paguaj shumën prej 50 euro, kurse të akuzuarit D. dhe D.K.2. secili veç e veç të paguajnë shumën prej 30 euro në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Konform nenit 62 par.1 nënpar.2.7 dhe nenit 69 par.3 të KPRK-së ndaj të akuzuarve S.M. dhe D.K.1. iu shqiptohet dënim plotësues. Të akuzuarit S.M. i konfiskohet revolva tipi “Sig Longer” me nr. serik 24 B 23461, kal. 9mm, si mjet i cili është përdorur për kryerjen e veprës penale kurse të akuzuarit D.K.1. i konfiskohet thika si mjet i vili është përdorur për kryerjen e veprës penale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshon ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj dënim me burg efektiv.

Përgjigje në ankesën e PTH ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit S.M. av. S.M., me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e Prokurorisë ta refuzojë dhe aktgjykimin e shkallës së parë ta vërtetojë.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.548/2017 të dt. 27.12.2017 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet ashtu që të akuzuarit S.M. të dënohet me burg efektiv. Kurse përgjigjja në ankesën e PTH e parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit av. S.M. të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të kodit penal e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë janë të bazuara.

Rrethanat e vlerësuara të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit S.M. sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk janë të natyrës së atillë që të ndikojnë që në rastin konkret të akuzuarit, për këtë veprë penale t'i shqiptohet një dënim kaq i ulët gjegjësisht dënim me kusht, kur kihet parasysh pesha e veprës penale, rrezikshmëria shoqërore e veprës penale, pasojat e kësaj vepre penale si dhe mënyra e kryerjes së kësaj vepre penale, prandaj kjo gjykatë të akuzuarit i shqiptoi dënimin sikur se në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ku edhe në shqiptimin e

dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e Apelit e Kosovës duke aplikuar dispozitat për zbutje të dënimit i ka shqiptuar të akuzuarit dënim në minimumin e paraparë ligjor, duke marrë si rrethanë lehtësuese pendimin e ti të thellë për kryerjen e veprave penale, premtimin se nuk do të përsërisin vepra të tilla apo çfarëdo qofshin ato, më parë të padënuar, ndaj të akuzuarit nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, të akuzuarit në mes të veti janë pajtuar dhe tani nuk kanë kurrfarë mosmarrëveshje dhe si rrethanë veçanërisht lehtësuese ndaj të akuzuarit gjykata mori parasysh pranimin e fajësisë për kryerjen e veprave penale për të cilën akuzohet, me bindje se ky dënim është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 402 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
PAKR.nr.584 /2017, më 12.01.2018

Procesmbajtësi,

Kryetarja e kolegjit- gjyqtarja

Përparim Zeka\_\_\_\_\_

1.Mejreme Memaj\_\_\_\_\_

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi\_\_\_\_\_

3. Have Haliti \_\_\_\_\_